



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 27, datë 20.11.2024

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË LEJEN E ZHVILLIMI PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIMI “TIRANA’S ROCK”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Ana” sh.p.k. dhe VI&VI” sh.p.k. , Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Lejen e Zhvillimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimi “Tirana’s Rock”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Ana” sh.p.k. dhe VI&VI” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr.09, datë 20.06.2018 të KKT-së.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 09, datë 20.06.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Marrëveshja për Delegimin e Kompetencave datë 20.06.2018 për objektinL: “Objekt banimi dhe shërbimi “Tirana’s Rock”, me 25 kate mbi tokë dhe 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, lidhur midis Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Bashkisë Tiranë, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.
4. Të gjitha procedurat administrative/ligjore për miratimin e rishikimeve dhe/ose ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe shtyrjen e afateve, të parashikuara në nenet 17, 17/1, 18 të VKM-së 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, për



objektin e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat ligjore të Ligj Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të ti, ndërsa çertifikata e përdorimit referuar nenit 27 të VKM-së 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar, do të lëshohen nga sekretariati teknik i KKT-së.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDDI RAMA



MINISTËR I LINJËSRISË
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 29/01/ 2026